

"ZHVLERËSIMI" I INDUSTRIË FASON



RAPORT MONITORIMI

Dhjetor 2023

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al



AUTOR

KOLINDO VJERDHA

"ZHVLERËSIMI" I INDUSTRIË FASON

Tabela e përmbajtjes:

• Hyrja	3
• Tranzicioni i sektorit fason në Shqipëri	3
• Kostot që rëndojnë industrinë	5
• Ndikimi i luhatjeve të monedhës Euro mbi sektorin fason	6
• "Kriza e re" e punonjësve	8
• Gjetjet kryesore	9
• Rekomandime	10
• Bibliografia	11



Hyrja

Ky raport analizon sfidat e reja me të cilat po përballet sektori fason për të mbijetuar në një treg të gjerë të një konkurrence ndërkombëtare, duke parashtruar gjithashtu problematikat me të cilat ndeshen aktorët kryesorë të kësaj industrie në Shqipëri.


Raporti sjell një panoramë të situatës financiare të bizneseve të këtij sektori duke evidentuar kostot e krijuara si pasojë e ndryshueshmërisë së indikatorëve ekonomik, por edhe vendimmarrjeve e politikave të dedikuara për këtë sektor. Bazuar në evidentimet e rasteve për përmirësim do të sillen gjithashtu edhe rekomandime specifike që ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e aktivitetit të këtij sektori.

Tranzicioni i sektorit fason në Shqipëri

Industria fasone në këto 32 vite njohu një zhvillim të shpejtë e favorizuar nga kostot e ulëta të krahut të punës dhe mbi të gjitha nga kostot e ulëta të transportit, të favorizuara nga pozicioni gjeografik i Shqipërisë.

Zhvillimet ekonomike dhe sfidat për të mbijetuar në treg detyruan njësitë ekonomike të kalonin në një fazë tranzitore të zhvillimit të proceseve të punës, duke shtuar më shumë shërbime gjithmonë edhe në bazë të kushteve të kërkuara nga njësitë ekonomike porositëse evropiane. Ky sektor në vitet e para karakterizohej nga njësi ekonomike të cilat bazonin aktivitetin e tyre vetëm në një proces të caktuar të zhvillimit të produktit dhe proceset e tjera kryheshin në njësi të tjera ekonomike mbi të cilat ishin lidhur kontratat nga njësitë porositëse të firmave evropiane në industrinë e veshjeve dhe këpucëve. Konkurenca për krahun e punës dhe dëshira për vazhdimësi e këtyre njësive ndikoi në transformimin e gamës së shërbimeve, duke u kthyer në njësi ekonomike të cilat përmbyllnin një cikël të plotë të prodhimit të produktit. Kjo solli jo vetëm zhvillim të sektorit, rritje të përfitueshmërisë, por mbi të gjitha krijoi më shumë hapësira punësimi të cilat ndikonin në zhvillimin ekonomik të vendit. Fuqia punëtore e gatshme për punësim në këtë sektor ishte favorizuese krahasuar me vendet e tjera në zhvillim gjë e cila me kalimin e viteve po humbet.


Tab.1 Eksportet e sektorit fason 2014-2022 (milionë lekë)



Burimi: INSTAT

Referuar të dhënave zyrtare nga INSTAT sektori i industrisë fason zë një pjesë të konsiderueshme të produkteve të eksportuara. Në vitin 2022 kjo kategori përbën 28.4% të produkteve të eksportuara, duke njohur një rritje me 21% krahasuar me vitin 2021. Në 8 vitet e fundit, po të përjashtojmë vitet 2020 dhe 2021 ku si shkak i pandemisë u pezullua aktiviteti për periudha të gjata kohore, trendi i ndjekur ndër vite ka qënë pozitiv sa i takon volumit të eksporteve. Përgjatë vitit 2022 eksportet për tekstile ishin 5.323 milionë lekë, për veshje ishin 65.880 milionë lekë dhe për lëkurë 65.864 milionë lekë, duke shënuar vlerat maksimale të këtyre 8 viteve.

Tab.2 Numër ndërmarrjesh të sektorit fason



Burimi: INSTAT

Në këtë sektor operojnë më shumë se 700 biznese që bëjnë pjesë në Dhomën Kombëtare të Prodhuesve të Veshjeve dhe Këpucëve, por në statusin aktiv që operojnë në treg numërohen mbi 900 biznese, ku kanë të punësuar rreth 66,000 punonjës. Janë mbyllur rreth 124 ndërmarrje nga viti 2020 si pasojë e vështirësive ekonomike të krijuara nga pandemia e Covid-19. Nga të dhënat e INSTAT në vitin 2022 operojnë 99 ndërmarrje eksporti me më shumë se 250 punonjës, ku duket se në tre vitet e fundit po njih një trend rritës. Në sektorin e eksporteve në tërësi janë të punësuar rreth 100,000 punonjës. Këto shifra dëshmojnë mbi peshën që zë ky sektor në ekonomi dhe mbi efektet që mund të pasojnë nga një destabilizim i tij.

Kostot që rëndojnë industrinë

Këto vite janë kthyer sfiduese për mbijetesën e këtij sektori, kjo si pasojë e ndikimeve thelbësore që kanë patur ndryshimet e vazhdueshme të indikatorëve ekonomik, por mbi të gjitha ndryshime e kushteve të tregut në të cilin operojnë këto biznese. Politikat e munguara suportuese nga shteti si dhe konkurenca ndërkombëtare duket se po ndikojnë në vështirësitë e krijuara në këtë industri.

Konkurenca e lartë duket se përbën sot një nga sfidat kryesore të këtij sektori. Qasja dhe kategorizimi i Shqipërisë si një mjedis i favorshëm për zhvillimin e kësaj natyre të të bërit biznes ka ndryshuar. Kostot e ulëta të prodhimit në tregjet aziatike, por edhe në vendet ballkanike si Maqedonia dhe Serbia, ka ndikuar në spostimin e kërkesës drejt këtyre vendeve duke dëmtuar bizneset fasone të që zhvillojnë aktivitetin në Shqipëri. Prodhimet tona u nënshtrohen akoma taksave doganore (12%) si në hyrje dhe në dalje në përputhje me ligjet doganore CEFTA¹ duke i nxjerrë akoma më shumë jashtë konkurrencës në krahasim edhe me vendet e treta si Pakistani e India.

Sektori i veshjeve dhe këpucëve ndikohet gjithashtu nga ndryshimet e vazhdueshme të modës. Kjo kërkon investime të vazhdueshme në inovacion dhe dalje në tregun ndërkombëtar. Mungesa e likuiditeve të bizneseve shqiptare në këtë sektor po e pamundëson këtë nevojë që ka tregu, gjë e cila po shoqërohet me vështirësi në menaxhimin e linjave të prodhimit. Ndryshimet e vazhdueshme stinore kanë reflektuar po ashtu në rritjen e stokeve për shkak të kërkesës më të ulët nga konsumatori i fundëm.

Kthimi i prioritetit në cilësinë e prodhimit detyrimisht shoqërohet me një nevojë obligative të kryerjes së investimeve në teknologji dhe praktika mjedisore. Këto nevoja që po diktohen nga konkurenca dhe tregu janë

¹Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore

të papërbalueshme nga bizneset shqiptare si pasojë e pozitive jo të favorshme financiare që ato kanë patur në vitet e fundit.


Politika e indeksimit të pagës minimale, ndonëse një nismë e drejtë për shkak të rritjes së inflacionit dhe çmimeve të produkteve të shportës, krijoi kosto të reja për bizneset e industrisë fasonë, të cilat pjesën më të madhe të të punësuarve e kanë në këtë fashë. Kostot për një punonjës janë rritur me 18% dhe kjo do të bëhet edhe më rënduese për bizneset nga Janari 2024, kur edhe do të përfundojë afati i politikës mbështetëse nga ana e qeverisë për të ndihmuar biznesin në kostot e reja të sigurimeve, të krijuara nga paga e re minimale. Ndryshe nga sektorë të tjerë që barrën e kostove shtesë e kalojnë te rritja e çmimeve të produkteve të tyre, ky sektor nuk mund ta realizojë diçka të fillë pasi marrëveshjet mbi çmimin vijnë nga palët e huaja dhe detyrimisht këto kosto do të rëndojnë drejtpërdrejt operatorët shqiptarë në këtë treg.-

Rritja e çmimit të energjisë elektrike ka ndikuar në rritjen me 71% të shpenzimeve të bizneseve për këtë zë nga 110 lekë për kilovat pa TVSH në 188 lekë për kilovat pa TVSH, duke rënduar edhe më shumë situatën financiare të tyre. Këto ndryshime janë shoqëruar edhe me paqëndrueshmëritë e vazhdueshme të çmimeve të naftës, gasoilit të cilat përbëjnë kosto shtesë për këtë industri.

Ndikimi i luhatjeve të monedhës Euro mbi sektorin fason

Luhatshmëria e kursit të këmbimit e Euros është kthyer në një nga problematikat kryesore me të cilat po përballet sektori fason që nga fillimi i vitit 2023. Duket se rimëkëmbja nga humbjet e shkaktuara nga pandemia Covid-19 po bëhet më e vështirë si pasojë e ndryshueshmërisë së indikatorëve të tjerë ekonomikë me ndikim të drejtpërdrejt në këtë sektor, i cili e bazon të gjithë aktivitetin e tij në eksporte. Dualizimi i përdorimit të monedhave krijon diferenca dhe humbje të vazhdueshme të shkaktuara nga rënia e kursit të këmbimit të Euros, ku afro 90% e kontratave të sektorit janë në vedet e Eurozonës. Të ardhurat në këtë sektor gjenerohen në Euro ndërsa shpenzimet gjenerohen në Lekë dhe kjo shërben si pikënisje e problematikave.

Tab.3 Eksportet në tremujorin e dytë 2023



Burimi: Banka e Shqipërisë

Në Raportin e Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë theksohet se në 6-mujorin e parë të vitit 2023 të ardhurat e gjeneruara nga sektori fason ishin 394 milionë lekë duke shënuar një rënie me afro 12.3% krahasuar me një vit më parë.

Sipas INSTAT, gjatë 9-mujorit 2023, të ardhurat nga eksportet e tekstileve shënuan rritje vjetore me 2,3%, ose 11,6 milionë euro në vlerë, teksa eksportuesit e këpucëve u përballën me rënie vjetore të shitjeve me rreth 45 milionë euro. Pas një fillim viti relativisht të mbarë, rënia nisi në prill. Ndonëse sektori u rikuperua në maj, iu rikthye sërish rënies në qershor-shtator, ku tkurrja më e thellë ishte në shtator. Ecurinë më negative e ka pasur sektori i prodhimit të këpucëve, me një rënie të eksporteve prej gati 10% për 9-mujorin, pasi është prekur nga rënia e kërkesës në Europë për shkak të inflacionit të lartë dhe motit të ngrohtë.

Tab.3 Krahasueshmëria në eksportet e tekstileve dhe këpucëve 2022-2023



Burimi: Revista Monitor

Përfitimet ekonomike në një periudhë 9-mujore kanë njohur rënie me 20% vetëm si pasojë e zhvlerësimit të euros. Ndonëse Banka e Shqipërisë ndërhyri në treg dhe rriti po ashtu me 60-80 milionë euro, shumën e planifikuar të blerjeve të valutës për vitin 2023, kursi i këmbimit mbeti të kufinj të mesatar të 105 lekëve. Ky stabilitet i ri ka ngritur alarmin brenda sektorit duke e cilësuar si një hap drejt falimentit, si pasojë e rëndesës së kostove.

Referuar të dhënave të marra nga shoqata "ProEksport Albania" deklarohet se dëmi ekonomik i shkaktuar nga luhatshmëria e kursit të këmbimit të Euros përlllogaritet 7.5 milion euro në muaj, e përkthyer rreth 100 Euro për punonjës. Këto janë kosto që rëndojnë drejtpërsëdrejti likuiditetet e biznesit të cilat mund të përdoshin për investime në sektor, rritje pagash apo promovim të bizneseve të sektorit.

"Krizë e re" e punonjësve

Dinamizmi i ekonomisë dhe luhatshmëria e indikatorëve kanë ndikuar në ndryshime kategorike të plotikave të ndërmarrja nga ky sektorë sa i takon fuqisë punëtore, duke ndryshuar totalisht çasjen ndaj punësimin. Kushtet e reja të tregut kanë detyruar bizneset e këtij sektori të ndërmarrin politika mbrojtëse dhe riskuese duke eskaluar deri në largime të detyruara të punonjësve ekzistues.

Ndryshimet kanë qënë radikale krahasuar me vitin 2021, pra dy vite më parë, ku përfaqësues të këtij sektori deklarorin për vështirësi në gjetjen e punonjësve, duke ofruar afro 20 000 vende pune të lira. Zhvillimet e fundit të mesit të vitit 2023, ku kursi i këmbimit të euros preku edhe minimumin historik (100,48 lekë) ndryshuan katërcipërisht këtë situatë duke detyruar bizneset të largonin punonjës aktual për të përballuar kështu humbjet e krijuara. Sektori nuk është më në vështirësi për gjetjen e punonjësve, por në pamundësi financiare për mbajtjen e tyre nga rritja e kostove.

Referuar të dhënave të deklaruara Shoqata "ProEksport Albania" shkurtimet e vendeve të punës në sektorin fason llogariten, 80 deri në 100 punonjës në ditë, ku zonat më të prekura janë Kruja, Fushë-Kruja, Laçi, Lezha e Shkodra. Shumë biznese kanë mungesë të theksuar likuiditeti dhe nuk arrijnë të paguajnë detyrimet që lindin nga aktiviteti i tyre.

Këto shkurtime të pozicioneve të punës kanë ardhur jo vetëm si pasojë e rënies së kursit të këmbimit të Euros, por edhe si pasojë e rënies së porosisë nga firmat e huaja. Rënia e porosive deri në 50% ka nisur nga

muaji qershor për sektorin e këpucëve, për shkak të magazinimit të mallit të pashitur nga mbajtja e dimrit të butë, por rënie po ashtu të porosive ka edhe sektori i prodhimit të veshjeve intimo dhe të punës.

Rritja e kostove në vendin tonë po largon prodhimin drejt vendeve të tjera ku "krahu" i punës paguhet më pak duke rrezikuar edhe më shumë këtë sektor i cili ka të punësuar një shifër të konsiderueshme rreth 66,000 punonjës. Rezikimi i këtij sektori do të sillte pasoja për ekonominë në tërësi, por mbi të gjitha do rëndonte më shumë kostot e buxhetit të shtetit.

Gjetjet kryesore

- Referuar të dhënave zyrtare nga INSTAT në vitin 2022 produktet nga sektori i industrisë fason përbëjnë 28.4% të produkteve të eksportuara, duke njohur një rritje me 21% krahasuar me vitin 2021. Përgjatë vitit 2022 eksportet për tekstile ishin 5.323 milionë lekë, për veshje ishin 65.880 milionë lekë dhe për lëkurë 65.864 milionë lekë, duke shënuar vlerat maksimale të këtyre 8 viteve.
- Operojnë në këtë sektor më shumë se 700 biznese që bëjnë pjesë në Dhomën Kombëtare të Prodhuesve të Veshjeve dhe Këpucëve, por në statusin aktiv që operojnë në treg numërohen mbi 900 biznese, ku kanë të punësuar rreth 66,000 punonjës. Janë mbyllur rreth 124 ndërmarrje nga viti 2020 si pasojë e vështirësive ekonomike të krijuara nga pandemia e Covid-19.
- Kostot kryesore që po e rëndojnë industrinë fasone lidhen me konkurrencën ndërkombëtare, zhvendosjen e prodhimit për shkak të kostove të ulëta drejt vendeve aziatike, Indisë, Pakistanit, por edhe vendeve ballkanike Serbisë dhe Maqedonisë. Sfiduese mbetet përshtatja me tregun në investime në cilësi, teknologji dhe inovacion.
- Kostot për një punonjës janë rritur me 18%, ndërsa ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike ka rritur shpenzimet për këtë zë me 71%.
- Në Raportin e Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë theksohet se në 6-mujorin e parë të vitit 2023 të ardhurat e gjeneruara nga sektori fason ishin 394 milionë lekë duke shënuar një rënie me afro 12.3% krahasuar me një vit më parë.
- Sipas INSTAT, gjatë 9-mujorit 2023, të ardhurat nga eksportet e tekstileve shënuan rritje vjetore me 2,3%, ose 11,6 milionë euro në vlerë, teksa eksportuesit e këpucëve u përballën me rënie vjetore të shitjeve me rreth 45 milionë euro apo 10%.

- Përfitimet ekonomike në këtë sektor në një periudhë 9-mujore kanë njohur rënie me 20% vetëm si pasojë e zhvlerësimit të euros. Dëmi ekonomik i shkaktuar nga luhatshmëria e kursit të këmbimit të Euros përlogaritet 7.5 milion euro në muaj, e përkthyer rreth 100 Euro për punonjës.
- Shkurtime të vendeve të punës në sektorin fason llogariten, 80 deri në 100 punonjës në ditë, ku zonat më të prekura janë Kruja, Fushë-Kruja, Laçi, Lezha e Shkodra.

Rekomandime

- Sigurimi i mbështetjes financiare për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në sektorin fason, përfshirë kredi të favorshme dhe grante, mund të ndihmojë ato të mbijetojnë periudha të vështira ekonomike.
- Implementimi i paketës "Manufakturë" të veshjeve dhe këpucëve, të kërkuar që 3 vite nga Shoqata "ProEksport Albania", e cila ridizenjon sektorin nga Fason në Prodhues të mirëfilltë, gjë që do përbënte vlerë e shtuar për ekonominë tonë, qëndrueshmëri dhe stabilitet ekonomik.
- Implementimin e një politike fiskale me taksa më të ulëta për këtë sektor duke ndihmuar në uljen e barrës fiskale dhe duke nxitur rritjen e investimeve brenda industrisë.
- Ndihma në promovimin e inovacionit dhe përdorimit të teknologjisë së re do të ndihmojë sektorin të përshtatet me kërkesat e ndryshme të tregut dhe të rritet në mënyrë që të jetë më konkurrues, në cilësi prodhimi, produktivitet dhe diversifikim të prodhimeve sipas kërkesave të tregut botërorë.
- Inkurajimi dhe mbështetja për ndërmarrjet që përdorin standarde të larta cilësore dhe mjedisore mund të ndihmojë në rritjen e besueshmërisë dhe konkurrencës në tregjet ndërkombëtare si dhe çertifikimi i tyre që automatikisht rrit vlerën e bizneseve, rrit mirëqenien dhe kushtet e punës për punëmarrësit dhe jep frymën e nevojshme që duhet të ketë.
- Shteti mund të ndihmojë në monitorimin e ndryshimeve në rregullimet tregtare ndërkombëtare dhe të përdorë diplomacinë ekonomike për të mbrojtur interesat e industrisë së fasonit në tregjet ndërkombëtare.

Bibliografia

- ❖ Raporti Tremujor i Politikës Monetare, (2023/III), Banka e Shqipërisë ([Raporti Tremujor i Politikës Monetare](#))
- ❖ Kërkesë për informim Nr. 86/2023 Prot.INT (10 Nëntor 2023), Shoqata ProEksport Albania
- ❖ Tregtia e jashtme e mallrave (Shtator 2023), INSTAT ([Tregtia e jashtme e mallrave](#))
- ❖ Statistika Import/ Eksport për tekstile, veshje , lëkurë, (2014-2022), INSTAT ([Import/ Eksport](#))
- ❖ Tregtia e jashtme e mallrave dhe ndërmarrjet (2022) INSTAT ([Tregtia e jashtme e mallrave dhe ndërmarrjet](#))
- ❖ Pas këpucëve nga rritja e kostove, bien porositë edhe për veshjet fason (Tetor 2023), Revista Monitor ([Pas këpucëve nga rritja e kostove, bien porositë edhe për veshjet fason](#))
- ❖ Shqipëri, industria fasone në vështirësi për shkak të zhvlerësimit të euros (Shtator 2023), Gazeta Telegraf ([Shqipëri, industria fasone në vështirësi për shkak të zhvlerësimit të euros](#))
- ❖ Si duhet të "riformatohet" industria fasone? (Tetor 2022), SCAN ([Si duhet të "riformatohet" industria fasone?](#))
- ❖ Kursi i Këmbimit Euro-Lek ([Kursi i Këmbimit](#))

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDORSEMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al